



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA DEVOLL
NJËSIA E PROKURIMIT

Nr _____ Prot

Devoll më ____/____/ 2026

PROCES-VERBAL – Tipi i kontratës - Mall
PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM
(Ky proces-verbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

I mbajtur sot më datë **09.03.2026**, në **Bashkinë Devoll**, nga Njësia e Prokurimit, ne lidhje me argumentimin dhe miratimin e dokumenteve të tenderit, specifikimeve teknike dhe kriterëve të veçanta për kualifikim, për procedurën e prokurimit me të dhënat e mëposhtme:

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Blerje karburant per nevoja te Bashkise Devoll Naftë dhe Benzine” i ndarë në lote.

Loti nr.1 Blerje Naftë

Loti nr.2 Blerje Benzine

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): 09132000-3 - Benzinë, 09134000-7 - Naftë

- I.** Fondi limit/vlera e pritshme e MK: **41,432,586 (dyzet e një milion e katerqind e tridhjetë e dy mijë e peseqind e tetëdhjetë e gjashtë) lekë pa tvsh ose 430,916 (katërqind e tridhjetë mijë e nëntëqind e gjashtëmbëdhjetë) Euro.** Kursi zyrtar i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë në datë 06/03/2026 është 96.15 Lekë/ Euro i ndare si me poshte:
- Loti 1 “Blerje Naftë”** me fond limit: 40,495,850 (dyzet milion e katerqind e nëntëdhjetë e pesë mijë e tetëqind e pesëdhjetë) lekë pa tvsh , ose 421,173 (katërqind e njëzet e një mijë e njëqind e shtatëdhjetë e tre) Euro. Kursi zyrtar i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë në datë 06/03/2026 është 96.15 Lekë/ Euro
- Loti 2 “Blerje Benzine”** me fond limit: 936,736 (nenteqind e tridhjetë e gjashtë mijë e shtateqind e tridhjetë e gjashtë) lekë pa tvsh ose 9,742 (nëntë mijë e shtatëqind e dyzet e dy) Euro. Kursi zyrtar i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë në datë 06/03/2026 është 96.15 Lekë/ Euro

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **Bashkia Devoll** ka hartuar proces-verbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

LOTI Nr.1 “ Blerje Nafta”

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9;

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP i ndryshuar , nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar . Kërkesat e mësipërme bazohen me Nenin 76 “Kriteret detyruese për skualifikim” Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” dhe Neni 83 ”Sigurimi i ofertes”, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar si dhe në mbështetje të Nenit 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” dhe nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik i ndryshuar

Neni 82, i LPP “1. Bashke me dorezimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si prova paraprake në vend të disa vërtetimeve të leshuara nga autoritetet publike ose pale të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik”.

Neni 83 i LPP “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme): me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 9.

Argumentimi:

Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 40, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Vërtetim nga administrata tatimore për xhiron e realizuar në 3 (tre) vitet e fundit 2023 2024 dhe 2025 nga shoqëria, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar, duhet të jetë jo më e vogël se dyfishi i vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet Loti I .

Nëse një operator ekonomik konkuron për të **2 (dy) Lotet** së bashku duhet të paraqesë vërtetim për xhiron vjetore të 3 (tre) viteve të fundit financiare ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se dyfishi i vlerës së përlllogaritur të loteve të marra së bashku për të cilat ofertuesi konkuron.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e përlllogaritur të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.i ndryshuar

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në **nenin 77 pika 3 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar**, ku parashikohet se: *“Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën”, “Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës”.*

si dhe bazuar në **nenin 43, pika 2/a, nenin 47 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”**, parashikohet se:

Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë:

a) dyfishin e vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar;

Vendosja e këtij kriteri kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik fitues i zotëron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën.

Duke marrë në konsideratë vlerën e fondit limit të kësaj procedure prokurimi, kërkohet që OE ofertues të paraqesë se disponon kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare për ta realizuar atë në kohë dhe në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara. Për këtë, OE ofertues duhet të ketë disponibilitetin e duhur ekonomik dhe me këtë qëllim, është argumentuar se vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet **të jetë jo më e vogël se dyfishi i vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet Loti I** dhe vendosja e këtij limiti nuk kufizon pjesëmarrjen e operatoreve ekonomike.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë në zbatim të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr.5, datë 30.01.2006, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, VKM-së Nr. 922 datë 29.12.2014 “Për deklarimin e detyrueshëm të deklarave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike”, si dhe kërkesave të Ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

Autoriteti Kontraktor në miratimin e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore”: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda **datës 31 mars të vitit pasardhës**, duke paraqitur në të njejtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.” pasi tatimpaguesit (operatorët ekonomikë) kanë detyrimin të dorëzojnë në administratën tatimore brenda **datës 31 mars të vitit pasardhës** bilancin kontabël së bashku me anekset e tij, si dhe Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabël të Autorizuar në rastet kur plotësohen kushtet e parashikuara nga ligji.

2.2.2 Për të vërtetuar një aktivitet pozitiv të qëndrueshëm Operatori ekonomik duhet të paraqesë Kopje të certifikuara të bilanceve të 3 (tri) viteve të fundit financiare (2022, 2023, 2024) të paraqitur në Autoritetet përkatëse Dega e Tatim Taksave të konfirmuara nga ky Autoritet si dhe të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar. (Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse në dy balance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negative ndërmjet aktivitet dhe pasivitet).

Shëmin: Akt Ekspertiza e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, duhet të paraqitet nga OE vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, gërma “c” të Ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, ku parashikohet se: “Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga eksperte kontabël ose shoqëri audituese: "c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vite radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm: i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh; ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh; iii) ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël”.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. Referuar në nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 40 % të vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet **Loti I**.

Nëse një operator ekonomik konkuron për të **2 (dy) Lotet** së bashku ,duhet të ketë realizuar gjatë 3 (tre) viteve të fundit **nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës** , furnizime të mëparshme të ngjashme, **në një vlerë jo më të vogël se 40%** e fondit limit të loteve të marra së bashku për të cilat ofertuesi konkurren.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a. për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

- b. për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 40, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë **në një vlerë jo më të vogël se 40 %** të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Vlera e kërkuar është vendosur që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme si dhe përvojën e duhur, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Përvoja e mëparshme është element shumë i nevojshëm që garantojnë autoritetin, se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së furnizimeve të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie. Vetë legjislacioni na përcakton qarte periudhën e kërkuar, vlerën e kërkuar dhe dokumentacionin konkret që duhet të dorëzojnë ofertuesit për të vërtetuar që kanë realizuar furnizime të ngjashme/

2.3.2 Operatori/et Ekonomik duhet të paraqesë/in liçensat përkatëse për tregtimin me pakicë të karburanteve, gazit të lëng-shëm të naftës, për automjetet, vajrave lubrifikant edhe lëndëve djegëse për përdorim nga konsumatorët fundorë nga Qendra Kombëtare e Licencimit (QKL).

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është në përputhje të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 40, pika 5/a, pika 7/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, i cili përcakton se: *“Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: a) liçencat profesionale për prodhimin dhe ose furnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore”* Me anë të këtij kriteri, kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë liçencat profesionale për furnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore. Gjithashtu, kjo kërkesë është bazuar dhe në Ligjin Nr.8450 dt.24.02.1999 “Për përpunimin, transportin dhe tregëtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre” si dhe në VKM nr.970 datë 2.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e liçencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj” i ndryshuar.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se zotërojnë liçencat profesionale për prodhimin dhe ose furnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore dhe ushtrojnë aktivitetin e tyre në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor, social dhe të punës ç’ka bën operatorin ekonomik fitues me të përgjigjshëm për produktet që oferton.

2.3.3 Operatori/et Ekonomik duhet të ketë te pakten 1 (nje) pike stacioni të shitjes së karburantit me pakicë brenda territorit administrativ të Bashkisë Devoll. (vertetuar me një nga format e

disponimit sipas Kodit Civil (akt pronësie ose kontratë qeraje ose kontratë furnizimi) ku të jetë e përcaktuar adresa e saktë.

Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 9 të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën referuar përcaktimeve të nenit 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar , përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është në përputhje të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 40, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, si dhe ligjit Nr.8450 datë 24.02.1999 “Për Përpunimin, Transportimin dhe Tregëtimin e Naftës, të Gazit dhe nën produkteve të tyre”.

Autoriteti Kontraktor përcakton kapacitetet profesionale dhe teknike me qëllim garantimin se Operatorët ekonomike zoterojnë mjetete dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion ose që mund të vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën me sukses. Kërkesa e mësipërme është e rëndësishme për AK pasi shoferet dhe mjetet e punës të Bashkisë Devoll duhet të furnizohen me karburant për të filluar punën në shërbim të komunitetit. Për këtë arsye është e rëndësishme që pika e stacionit të jetë në territorin e Bashkisë Devoll për të shmangur koston për AK në buxhet, në kohë dhe në dëm të punëve publike të institucionit nëse do të furnizoheshin në pika me karburant jashtë territorit të Bashkisë Devoll.

Kërkesa për një pikë stacioni në territorin e Bashkisë Devoll është një kriter në përputhje të plotë me objektin e kontratës.

Njësia e Prokurimit, për mos ta kufizuar këtë kriter ka gjykuar dhe ka kërkuar si alternativë një nga format e disponimit sipas Kodit Civil për këto stacione, përveç kontratës së qirasë ose aktit të pronësisë ka kërkuar edhe kontratë furnizimi ku të jetë e përcaktuar adresa e saktë.

2.3.4 Operatori/et Ekonomik duhet të detyrimisht duhet të paraqes/in Fletë analizë të lëshuar nga Inspektoriati Shtetror Teknik dhe industrial “ISHTI” Fletë analiza duhet të jetë lëshuar brenda 6 (gjashtë) muajve të fundit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162 datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar , nenin 40 pika 6 gërma c,) të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar , VKM nr. 410, datë 13.5.2015 “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit Shtetëror Teknik dhe Industrial”, VKM nr. 147 datë 21.3.2007 “Për cilësinë e lëndëve djegëse, Benzinë dhe Diezel”.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të paraqesin dëshmi për rezultatet e testimeve zyrtare, të cilat duhet të jenë të lëshuara nga institucioni i autorizuar ISHTI (e cila është struktura përgjegjëse për inspektimin për zbatimin dhe përmbushjen e kërkesave ligjore dhe nënligjore në fushën e përpunimit, transportimit dhe tregimit të naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre, sipas legjislacionit përkatës) dhe që vërteton pajtueshmërinë e parametrave cilësorë të karburantit me specifikimet teknike.

Lidhur me afatin e lëshimit të raportit të analizimit të karburantit nga strukturat e autorizuar, jemi referuar parashikimit të urdhrin nr. 6 datë 9.1.2015 “Për kontrollin e standarteve teknike të naftës dhe nënprodukteve të saj, procedurat dhe tarifat”, i ndryshuar, të Ministrit të Energjisë dhe Industrisë, pika II/4/c

2.3.5 Operatori/et Ekonomik duhet të ketë-në në pronësi ose me qera 1 (një) autobot të posaçëm për transport të lëndëve të rrezikshme së bashku me aparatin matës (kondralitër). Autoboti do të shërbejë për transportin e karburantit në vendin ku ndodhen depozitat dhe mjetet e tonazhit të rëndë të autoritetit kontraktor.

Autoboti duhet të jetë i pajisur me Leje Qarkullimi (në rastet kur janë në pronësi) ose kontratën e vlefshme të qerash + leje qarkullimi (në rastet e marrjes me qera) si dhe Çertifikatën e Kontrollit

Teknik, siguracionin e mjetit dhe pasaportën e mjetit. Automjeti të ketë të vendosur kontalitrin e kalibruar dhe certifikuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë të vërtetuar me certifikatën e lëshuar nga kjo drejtori. Për arsye të vendodhjes së depozitave dhe mjeteve të tonazhit të rëndë të autoritetit kontraktor dhe vështirësisë në rastet e furnizimit autoboti duhet të ketë vëllim jo më të madh se 1000 (njemijë) litra.

Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 9 të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën referuar përcaktimeve të nenit 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar , përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

Argumentim: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 40, pika 5/ç, të VKMnr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar , me anë të këtyre kriterëve kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit. Gjithashtu janë përcaktuar në funksion të vlerësimit dhe garantimit të cilësisë së mallit objekt prokurimi, aftësisë dhe zotërimit të aseteve të nevojshme fizike (mjete transporti/autobote) të operatorit ekonomik për të realizuar furnizimin e mallit (karburant) në përputhje me specifikimet teknike dhe standardet e kërkuara. Vetë natyra dhe rëndësia e veçantë e artikullit objekt prokurimi kërkon garancinë dhe vëmendjen e duhur si nga AK ashtu dhe nga operatorët ekonomik pjesëmarrës.

Autoboti është kërkuar në rastet e punëve dhe emergjencave kur mjetet e tonazhit të rëndë ose zjarrfikset etj, lëvizja e të cilave për tu furnizuar me karburant pranë pikës së shitjes së kontraktuesit do të sillte kosto dhe dëmë financiare dhe negative për AK dhe qytetarët. AK rrit konkurrencën për të gjithë OE të interesuar për zbatimin e kontratës duke lejuar të gjitha format që parashikon Kodi Civil për disponimin e mjetit.

2.3.6 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë deklaratat si mëposhtë:

- Operatori/et Ekonomik duhet të deklarojë/në, se merr përsipër furnizimin pranë stacioneve të shitjes së karburanteve me pakicë me shërbim 24 orë sipas kërkesave të Autoritetit Kontraktor.
- Operatori/et Ekonomik duhet të deklarojë/në se merr përsipër furnizimin me karburant detyrimisht me pistoletë publike.
- Operatori ekonomik duhet të deklarojë se do të mbulojë furnizimin nëpërmjet kartave elektronike të personalizuar, sipas adresave të kërkuara nga Autoritetit Kontraktor. Kartat elektronike, duhet të jenë pa skadencë dhe të jenë të përdorshme deri në perfundimin e levrimit të gjithë mallit
- Bazuar në VKM Nr 561 datë 29.07.2016 “**Për Standartizimin dhe disiplinimin e shpenzimeve të karburantit në njësitë e qeverisjes së përgjithshme**“, Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të ofrojnë një faqe menaxhimi të karburanteve (webpage), ku furnizimi dhe shpenzimi i karburantit për mjetet efektive të transportit të kryhet nëpërmjet kartës elektronike.

Argumentim: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe pikës 8 të nenit 40, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar , me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë disponueshmërinë e tyre për furnizimin me karburant në vendet e përcaktuara nga AK sipas kërkesave të tij në funksion të mbarëvajtjes së proceseve të punës. Deklarata për furnizimin pranë stacioneve të shitjes së karburanteve me pakicë me shërbim 24 orë sipas kërkesave të Autoritetit Kontraktor është në përputhje me qëllimin dhe objektin e

kontratës. Mjetet e Bashkisë Devoll për raste emergjente dhe punë të ndryshme në shërbim të komunitetit mund të kenë nevojë për furnizimi në cdo orë të ditës dhe natës.

2.3.7 Bashkia Devoll rezervon të drejtën që kur e gjykon të nevojshme të kërkojë kontrollin e cilësisë së karburantit. Deklaratë për shpenzimet e kontrollit të cilësisë të përballohen nga operatori ekonomik

Argumentim: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe pikës 8 të nenit 40, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.i ndryshuar

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike:

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.***

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Specifikimet teknike janë hartuar nga komisioni i ngritur me urdhër të titullarit duke marrë në konsideratë nevojat e Autoritetit Kontraktor, për mallrat objekt prokurimi, duke përllogaritur sasitë e nevojshme, karakteristikat e duhura dhe standardet e duhura kombëtare dhe ndërkombëtare.(bashkengjitur dokumentave të tenderit)

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9;

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP i ndryshuar, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Kërkesat e mësipërme bazohen me Nenin 76 “Kriteret detyruese për skualifikim” Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” dhe Neni 83 “Sigurimi i ofertes”, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar si dhe në mbështetje të Nenit 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” dhe nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik i ndryshuar

Neni 82, i LPP “1. Bashke me dorezimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si prova paraprake në vend të disa vertetimeve të leshuara nga autoritetet publike ose pale të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik”.

Neni 83 i LPP “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme): me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 9.

Argumentimi:

Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 40, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Vërtetim nga administrata tatimore për xhiron e realizuar në 3 (tre) vitet e fundit 2022 2023 dhe 2024 nga shoqëria, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar, duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet Loti II .

Kur konkuron për të 2 (dy) Lotet së bashku ofertuesi duhet të paraqesë vërtetim për xhiron vjetore të 3 (tre) viteve të fundit financiare ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e

periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se dyfishi i vlerës së përlogaritur të LOTEVE për të cilat ofertuesi konkurron.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 42 dhe 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në **nenin 77 pika 3 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”**, ku parashikohet se: *“Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën”, “Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës”.*

si dhe bazuar në nenin 43, pika 2/c, nenin 47 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, parashikohet se:

Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë:

a) 40% te vlerese te perlogaritur te kontrates ne procedurat e prokueimit nene kufirin e ulet monetar.;

Si dhe bazuar ne nenin 42 pika 3 e VKM-se 285 ” Kur kontrata per pune mallra sherbim ndahet ne lote, Autoriteit Kontraktor duhet te hartoje kerkesat e vecanta te kualifikimit per secilin lot, kerkesat duhet te jene ne perpjestim dhe te lidhura ngushte me objektin, natyren dhe vleren e lotit.

Vendosja e këtij kriteri kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik fitues i zotëron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën.

Duke marrë në konsideratë vlerën e fondit limit të kësaj procedure prokurimi, kërkohet që OE ofertues të paraqesë se disponon kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare për ta realizuar atë në kohë dhe në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara. Për këtë, OE ofertues duhet të ketë disponibilitetin e duhur ekonomik dhe me këtë qëllim, është argumentuar se vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet **të jetë jo më e vogël se 40% së përlogaritur të kontratës që prokurohet Loti II** dhe vendosja e këtij limiti nuk kufizon pjesëmarrjen e operatoreve ekonomike.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë në zbatim të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr.5, datë 30.01.2006, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, VKM-së Nr. 922 datë 29.12.2014 “Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike”, si dhe kërkesave të Ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

Autoriteti Kontraktor në miratimin e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore”: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore

brenda **datës 31 mars të vitit pasardhës**, duke paraqitur në të njejtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhëne tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.“ pasi tatimpaguesit (operatorët ekonomikë) kanë detyrimin të dorëzojnë në administratën tatimore brenda **datës 31 mars të vitit pasardhës** bilancin kontabël së bashku me anekset e tij, si dhe Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabël të Autorizuar në rastet kur plotësohen kushtet e parashikuara nga ligji.

2.2.2 Për të vërtetuar një aktivitet pozitiv të qëndrueshëm Operatori ekonomik duhet të paraqesë Kopje të certifikuara të balanceve të 3 (tri) viteve të fundit financiare (2022, 2023, 2024) të paraqitur në Autoritetet përkatëse Dega e Tatim Taksave të konfirmuara nga ky Autoritet si dhe të shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel të Autorizuar. (Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse në dy balance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivit).

Shëmin: Akt Ekspertiza e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, duhet të paraqitet nga OE vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, gërma “c” të Ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, ku parashikohet se: “Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga eksperte kontabël ose shoqëri audituese: "c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vite radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm: i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh; ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh; iii) ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël”.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e balanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. Referuar në nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njejtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhëne tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.

2.4 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet **Loti II**.

Kur konkurron për të (2) dy lotet së bashku Operatori Ekonomik duhet të ketë realizuar gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, furnizime të mëparshme, të ngjashme, në një vlerë jo më të vogël se 40% e fondit limit të LOTEVE për të cilat ofertuesi

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- c. për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
- d. për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 55, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë **në një vlerë jo më të vogël se 20 %** të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Kontrata e ngjashme është e domosdoshme për të vërtetuar eksperiencën e operatoreve ekonomik ofertues, me qëllim që të garantohet zbatimi i kontratës me sukses.

Si dhe bazuar në nenin 42 pika 3 e VKM-se 285 ” Kur kontrata për punë mallra shërbim ndahet në lote, Autoriteti Kontraktor duhet të hartojë kërkesat e vecanta të kualifikimit për secilin lot, kërkesat duhet të jenë në përpjestim dhe të lidhura ngushtë me objektin, natyrën dhe vlerën e lotit.

2.3.2 Operatori/et Ekonomik duhet të paraqes/in liçensat përkatëse për tregtimin me pakicë të karburanteve, gazit të lëng-shëm të naftës, për automjetet, vajrave lubrifikant edhe lëndëve djegëse për përdorim nga konsumatorët fundorë nga Qendra Kombëtare e Licencimit (QKL).

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është në përputhje të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 40, pika 5/a, pika 7/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, i cili përcakton se: “Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: a) liçencat profesionale për prodhimin dhe ose furnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore” Me anë të këtij kriteri, kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë liçencat profesionale për furnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore. Gjithashtu, kjo kërkesë është bazuar dhe në Ligjin Nr.8450 dt.24.02.1999 “Për përpunimin, transportin dhe tregëtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre” si dhe në VKM nr.970 datë 2.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e liçencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj” i ndryshuar.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se zotërojnë licencat profesionale për prodhimin dhe ose furnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore dhe ushtrojnë aktivitetin e tyre në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor, social dhe të punës ç'ka bën operatorin ekonomik fitues me të përgjëgjshëm për produktet që oferton.

2.3.3 Operatori/et Ekonomik duhet të ketë te pakten 1 (nje) pike stacioni të shitjes së karburantit me pakicë brenda territorit administrativ të Bashkise Devoll. (vertetuar me një nga format e disponimit sipas Kodit Civil (akt pronësie ose kontratë qeraje ose kontratë furnizimi) ku të jetë e përcaktuar adresa e saktë.

Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 9 të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën referuar përcaktimeve të nenit 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar , përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është në përputhje të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 40, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, si dhe ligjit Nr.8450 datë 24.02.1999 “Për Përpunimin, Transportimin dhe Tregëtimin e Naftës, të Gazit dhe nën produkteve të tyre”.

Autoriteti Kontraktor përcakton kapacitetet profesionale dhe teknike me qëllim garantimin se Operoret ekonomike zoterojne mjetete dhe pajisjet teknike qe ka ne dispozicion ose qe mund te vihen ne dispozicion operatorit ekonomik per te permbushur kontraten me sukses. Kerkesa e mesiperme eshte e rendesishme per AK pasi shoferet dhe mjetet e punes te Bashkise Devoll duhet te furnizohen me karburant per te filluar punen ne sherbim te komunitetit. Per kete arsye eshte e rendesishme qe pika e stacionit te jete ne territorin e Bashkise Devoll per te shmangur kosto per AK ne buxhet, në kohë dhe në dëm të punëve publike të institucionit nese do te furnizoheshin në pika me karburant jashtë territorit të Bashkisë Devoll.

Kerkesa për një pikë stacioni në territorin e Bashkisë Devoll është një kriter në përputhje të plotë me objektin e kontratës.

Njësia e Prokurimit, për mos ta kufizuar këtë kriter ka gjykuar dhe ka kërkuar si alternativë një nga format e disponimit sipas Kodit Civil për këto stacione, pervec kontratës së qirasë ose aktit të pronësisë ka kërkuar edhe kontratë furnizimi ku të jetë e përcaktuar adresa e saktë.

2.3.4 Operatori/et Ekonomik duhet të detyrimisht duhet të paraqes/in Fletë analizë të lëshuar nga Inspektoriati Shtetror Teknik dhe industrial “ISHTI”Fletë analiza duhet të jetë lshuar brenda **6 (gjashte) muajve** te fundit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162 datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar , nenin 40 pika 6 gërma c,) të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar , VKM nr. 410, datë 13.5.2015 ”Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit Shtetëror Teknik dhe Industrial”, VKM nr. 147 datë 21.3.2007 “Për cilësinë e lëndëve djegëse, Benzinë dhe Diezel”.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të paraqesin dëshmi për rezultatet e testimeve zyrtare, të cilat duhet të jenë të lëshuara nga institucioni i autorizuar ISHTI (e cila është struktura përgjegjëse për inspektimin për zbatimin dhe përmbushjen e kërkesave ligjore dhe nënligjore në fushën e përpunimit, transportimit dhe tregimit të naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre, sipas legjislacionit përkatës) dhe që vërteton pajtueshmërinë e parametrave cilësorë të karburantit me specifikimet teknike.

Lidhur me afatin e lëshimit të raportit të analizimit të karburantit nga strukturat e autorizuar, jemi referuar parashikimit të urdhrin nr. 6 datë 9.1.2015 ”Për kontrollin e standarteve teknike të naftës dhe nënprodukteve të saj, procedurat dhe tarifat”, i ndryshuar, të Ministrit të Energjisë dhe Industrisë, pika II/4/c

2.3.5 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë deklaratat si mëposhtë:

- Operatori/et Ekonomik duhet të deklarojë/në, se merr përsipër furnizimin pranë stacioneve të shitjes së karburanteve me pakicë me shërbim 24 orë sipas kërkesave të Autoritetit Kontraktor.
- Operatori/et Ekonomik duhet të deklarojë/në se merr përsipër furnizimin me karburant detyrimisht me pistoletë publike.
- Operatori ekonomik duhet të deklarojë se do të mbulojë furnizimin nëpërmjet kartave elektronike të personalizuar, sipas adresave të kërkuara nga Autoritetit Kontraktor. Kartat elektronike, duhet të jenë pa skadencë dhe të jenë të përdorshme deri në perfundimin e levrimit të gjithë mallit
- Bazuar në VKM Nr 561 datë 29.07.2016 **“Për Standartizimin dhe disiplinimin e shpenzimeve të karburantit në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”**, Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të ofrojnë një faqe menaxhimi të karburanteve (webpage), ku furnizimi dhe shpenzimi i karburantit për mjetet efektive të transportit të kryhet nëpërmjet kartës elektronike.

Argumentim: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe pikës 8 të nenit 40, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar , me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë disponueshmërinë e tyre për furnizimin me karburant në vendet e përcaktuara nga AK sipas kërkesave të tij në funksion të mbarëvajtjes së proceseve të punës. Deklarata për furnizimin pranë stacioneve të shitjes së karburanteve me pakicë me shërbim 24 orë sipas kërkesave të Autoritetit Kontraktor është në përputhje me qëllimin dhe objektin e kontratës. Mjetet e Bashkisë Devoll për raste emergjente dhe punë të ndryshme në shërbim të komunitetit mund të kenë nevojë për furnizimi në cdo orë të ditës dhe natës.

2.3.6 Bashkia Devoll rezervon të drejtën që kur e gjykon të nevojshme të kërkojë kontrollin e cilësisë së karburantit.Deklaratë për shpenzimet e kontrollit të cilësisë të përballohen nga operatori ekonomik

Argumentim: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe pikës 8 të nenit 40, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.i ndryshuar

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike:

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.***

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Specifikimet teknike janë hartuar nga komisioni i ngritur me urdhër të titullarit duke marrë në konsideratë nevojat e Autoritetit Kontraktor, për mallrat objekt prokurimi, duke përllogaritur sasi të e nevojshme, karakteristikat e duhura dhe standardet e duhura kombëtare dhe ndërkombëtare.(bashkengjitur dokumentave të tenderit)

NJESIA E PROKURIMIT: